



Datë 26. 01. 2026

PROCESVERBAL –Tipi i kontratës - Sherbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Studim projektim për objektin ndërtim i muzeut të naftës dhe aviacionit si dhe rikonstrukcioni i bulevardit ‘Dëshmorët e Kombit’”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Kodi 22114311-5 (Projekte)

VLERA E FONDIT LIMIT: 2 493 935,81 *(dy milion e katërqind e nëntëmbëdhjetë e tre mijë presje tetëdhjetë e një) lekë pa tvsh.*

Afati për zbatimin e kontratës do të jetë: 3 (tre) muaj duke filluar nga data e lidhjes së kontratës.

Bazuar në nenin 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenin 2, pika 2/c dhe nenin 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Njësia e Prokurimit, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit janë standarte dhe nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 12*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 5;*

Argumentimi: Kërkesa 1. a bazohet në nenet 76,77 dhe 82 të LPP si dhe nenit 26 të VKM nr 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Kërkesa 1.b është vendosur bazuar në nenin 83 të LPP dhe nenit 30 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore (Sipas QKB) për vitin 2025 sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore, duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij sipas QKB-së.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Për Taksat Lokale

Në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 9 përcaktohet se :

Në taksat vendore përfshihen :

1. Taksa vendore mbi biznesin e vogël.
2. Taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat dhe taksa mbi tokën bujqësore.
3. Taksa e fjetjes në hotel.

4. Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.
5. Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.
6. Taksa e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve.
7. Taksa për zënien e hapësirave publike.
8. Taksa e tabelës.
9. Taksa të përkohshme.

Në nenin 14 po këtu, përcaktohet se : “1. Taksa paguhet në katër këste të barabarta. Kësti i parë paguhet brenda datës 20 prill. Kësti i dytë jo më vonë se data 20 korrik, kësti i tretë jo më vonë se data 20 tetor dhe kësti i fundit jo më vonë se data 20 janar e vitit të ardhshëm fiskal”.

Bazuar mbi sa më sipër kërkesa e autoritetit kontraktor për pagesën e taksave lokale është në përputhje me ligjin 9632 datë 30.10.2006 ”Për sistemin e taksave vendore”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas shtojces 11.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 30 % të vlerës së përlogaritur të kontratës.

(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Lloji i procedures është shërbim, nën kufirin e ulët monetar, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2, germa ”c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në mbështetje të nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar

nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”, Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij., VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 “Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike.

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben AK për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Vërtetim për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2022 (Sipas QKB) sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore, si dhe për vitin 2023 duke mbajtur në konsideratë dhe përcaktimet e Ligjit Nr 9632, datë 31.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, pranë njësive vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij sipas QKB-së.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Vendosja e kërkesës për detyrimet vendore për vitin 2022 dhe vitin 2023 (kesti maturuar) është bërë në mbështetje të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.(sipas të cilit, operatorët ekonomikë duhet të shlyejnë detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, në çdo adresë ku ushtrojnë aktivitet).

2.2.3 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të japin informacione në bilancet e tyre vjetore për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare duke filluar nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. .

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: "Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c" të Ligjit nr. 1009/2009: "*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Kapaciteti teknik :

2.3.1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Per te provuar pervojën e meparshme operatori ekonomik duhet te paraqese deshmi per realizimin me sukses te nje ose disa kontratatave per sherbimet e meparshme, te ngjashme me fushat perkatese te ekspertizes, pjese e objektit te prokurimit, ne nje vlere jo me te vogel se 30% e vleres se perllogaritur te kontrates qe prokurohet dhe qe eshte realizuar gjate 3 viteve te fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates.

- a) Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet te paraqese vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes, ku te jene shenuar sakte datat, shumat dhe sherbimet e realizuara,
ose
- b) Ne rast se pervoja e meparshme eshte realizuar me sektorin privat, si deshmi do te pranohen vetem fatura tatimore shitje, te plotesuara sipas kerkesave te legjislacionit ne fuqi dhe te deklaruar ne organet tatimore ku te jene shenuar sakte datat, shumat dhe sherbimet e realizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Ne rastin e bashkimit të operatoreve secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të përmbushë kërkesat e mësipërme në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në shërbim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41 dhe 88 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në rastin e prokurimit të shërbimeve me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme, si përvojë e mëparshme për shërbimet e ngjashme me objektin e prokurimit do të njihen dhe/ose shërbimet e ngjashme me fushat përkatëse të ekspertizës, pjesë e objektit të prokurimi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të paraqesë Liçensën profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për

dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mëposhtme:

2/b /2 - qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore;

2/d - Projektim pejsazhi, sistemi sipërfaqe të gjelberta, lulishte e parqe

3/a - Objekte civile –industriale-turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate

4/a - Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.

4/c - Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.

4/f - Projektim të sistemeve kundër zjarrit.

4/i - Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroporteve etj.

4/j - Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.

6/a - Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.

11/a - Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime.

(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Sqarim:

Për licensat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë ose institucione të tjera të autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e liçensave profesionale në fushën e studim projektimit në ndërtim), e vlefshme, ku të përfshihen kategoritë e mësipërme me ndryshimet përkatëse në emërtesë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), nenin 41, pika 4, gërma a,) të VKM nr.285,

datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016 ”Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licensat e mësipërme janë vendosur në kuadër të natyrës së përgjithshme të punimeve që priten të realizohen në këtë procedurë.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për çdo kategori si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pikat e kategorisë	Përshkrimi për kategoritë
Projektues Arkitekt	2/b /2 - qendra tregtare; objekte social kulturore; objekte kulti; objekte arsimore	<i>Duke ju referuar Detyrës të Projektimit parashikohet ndërtimi i Muzeut të qytetit të Kuçovës.</i>
	2/d - Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe.	<i>Të parashikohet sistemimi i terreneve të jashtme dhe ambienteve të gjelbërta si për muzeun edhe për bulevardin dhe sheshin përpara Bashkisë.</i>
Projektues Konstruktor	3/a - Projektim objekte civile - industriale – turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.	<i>Projektim i strukturave të objekteve me karakter social me lartësi deri në 5 kate (shkolle), ku parashikohet rikonstruksioni i tarracës, perforcimi/riparimi i muraturës mbajtëse, suvatimi i obejktit, izolimi i dysHEMEVE ETJ.</i>
Projektues Instalator	4/a - Projektim të instalimeve hidro-termosanitare.	<i>Te parashikohen ambiente sanitare të cilat përfshijn vendosjen e lavamanëve, instalimi i bolierve, ventilimi i ktyre hapsirave etj.</i>
	4/c - Projektim të linjave të rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale.	<i>Duke ju referuar Detyrës të Projektimit parashikohet të kryhen punime të rrejtit elektrik të Muzeut të qytetit të Kuçovës.</i>
	4/f - Projektim të sistemeve kundra zjarrit.	<i>Të parashikohet projekti i mbrojtjes nga zjarri si dhe rregullat e sigurimit teknik për MZSH sipas normave dhe standarteve europiane, vendosja e një kabine telefonike ,sistem alarmi, sinjalizuesit e tymit, bombulat fikëse të zjarrit etj</i>
	4/j - Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV,	<i>Të parashikohet instalimi i ri telefonik dhe rrjetin e internetit, sistemet e alarmit sistemet e dedektimit të zjarrit në Muzeun e qytetit të Kuçovës.</i>

	sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.	
PROJEKTUES RRUGE - HEKURUDHA	6/a- Rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore.	<i>Duke ju referuar Detyrës të Projektimit do të parashikohen punime në infrastrukturën rrugore, për rikualifikimin urban të segmentit kryesor të bulevardit si dhe rikonceptimi i sheshit para Bashkisë me synimin për të përmirësuar cilësinë e hapësirës publike</i>
PROJEKTUES TË SINJALIZIMIT RRUGOR	11/ a- Sinjalistikë jondriçuese në rrugë lokale, rrugë urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe e parkime	<i>Rrugët do të jenë të vijëzuara me sinjalistikë horizontale dhe kalime për këmbësorë, tabela të sinjalistikës vertikale në rrugë, për të hartuar një sistem sinjalistik në përputhje me standardet dhe kodet kombëtare për sigurinë e qarkullimit në rrugë.</i>

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë përfshirë si drejtues teknik dhe të figurojë në Liçencën e shoqërisë, stafin e mëposhtëm:

- Projektues Arkitekt (1 një)
- Projektues Ixhinier Ndertimi (1 një)

Për stafin e mësipërm, duhen paraqitur për secilin:

- Diploma
- Kontrata e punës (e vlefshme dhe e rregullt nga ana ligjore).
- Si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë në datën e hapjes së ofertave.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht, Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar detyrave dhe objektiva të përshkruara në Termat e Referencës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Nevoja për këta inxhinierë është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni në fushën e studim projektimit në ndërtim. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Argumentim i detajuar teknike në lidhje me drejtuesit teknik të kërkuar më lart :

Lidhur me Projektues Arkitekt (1 një)

Konsiderohen të nevojshëm për hartimin e projektit, planifikimin, projektimin e ndërtimit të objekteve si për Muzeun e qytetit ashtu edhe për bulevardin pranë Bashkisë, si dhe teknikave të përdorura në zhvillimin e tyre. Duke qenë se do të hartohen dy projekte të ndryshme dhe për 1 afat 3 muaj për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa e mësipërme është në përputhje me objektin e kontratës.

Lidhur me Projektues Ixhinier Ndertimi (1 një)

Konsiderohen të nevojshëm për hartimin e projektit të zbatimit dhe relacionit përkatës sipas përcaktimeve në detyrën e projektimit. Një projektues inxhinier ndërtimi është përgjegjës për planifikimin dhe projektimin e projekteve të ndërtimit që janë të qëndrueshme, të sigura dhe të përputhshme me standardet e kërkuara, duke siguruar që ato të jenë të realizueshme ekonomikisht dhe teknologjikisht.

- Siguron që të gjitha strukturat të jenë të qëndrueshme dhe të sigura për përdoruesit e tyre.
- Optimizon projektet për të ulur kostot dhe për të arritur rezultatet më të mira në aspektin e kohës dhe burimeve.
- Mundëson ndërtimin e hapësirave që përmirësojnë cilësinë e jetesës për banorët, përdoruesit dhe komunitetin.
- Siguron që projektet të jenë në përputhje me ligjet dhe rregullat, përfshirë ato për mbrojtjen e mjedisit dhe sigurinë.

2.3.4 Për realizimin e kontratës me sukses ofertuesit duhet të disponojnë dhe stafin me kontrate si më poshtë (jo detyrimisht si drejtues teknik):

- Projektues Arkitekt (1 një)

- Projektues Mekanik (1 nje)
- Projektues Elektrik (1 nje)
- Projektues Gjeodet (1 nje)
- Inxhinier Gjeolog (1 nje)
- Inxhinier Hidroteknik (1 nje)
- Preventivues (1 nje)
- Specialist Mjedisi (1 nje)

Për stafin e mësipërm, duhen paraqitur për secilin :

- Diploma
- Kontrata e punës (e vlefshme dhe e rregullt nga ana ligjore).
- Si dhe të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë në datën e hapjes së ofertave.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomik duhet të vetdeklarojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar), me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht, Njesia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar detyrave dhe objektiva të përshkruara në Termat e Referencës.

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës. Nevoja për këta inxhinierë është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni në fushën e studimit projektimit në ndërtim. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Argumentim i detajuar teknike në lidhje me stafin me kontratë të kërkuar më lart :

- **Lidhur me Projektues Arkitekt (1 një)**

Konsiderohen të nevojshëm për hartimin e projektit, planifikimin, projektimin e ndërtimit të objekteve si për Muzeun e qytetit ashtu edhe për bulevardin pranë Bashkisë, si dhe teknikave të

përdorura në zhvillimin e tyre. Duke qenë se do të hartohen dy projekte të ndryshme dhe për 1 afat 3 muaj për zbatimin e kontratës me sukses dhe në kohë, njësia e prokurimit gjykon se kërkesa e mësipërme është në përputhje me objektin e kontratës.

- Projektues Mekanik (1 një)

Projektues mekanik është i nevojshem pasi do të hartojë projektin e mbrojtjes nga zjarri si dhe rregullat e sigurimit teknik për MZSH sipas normave dhe standarteve europiane, vendosja e një kabine telefonike, sistem alarmi, sinjalizuesit e tymit, bombulat fikëse të zjarrit etj, në Muzen e qytetit të Kuçovës.

- Projektues Elektrik (1 një)

Projektues elektrik është i nevojshem pasi do të hartojë punime të rrejtit elektrikut të Muzeut të qytetit të Kuçovës, sipas liçensës (4/c - Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale).

- Projektues Gjeodet (1 një)

Projektues gjeodet konsiderohet i nevojshëm për hartimin e projektit të zbatimit të rrugës/bulevardit dhe sheshit përpara Bashkisë, i cili është thelbësor për sigurinë dhe saktësinë e ndërtimit të rrugës, pasi siguron matje të sakta të terrenit dhe mundëson planifikimin dhe projektimin e rrugës në përputhje me realitetin gjeografik dhe gjeoteknik të zonës. Gjeodetët janë të përfshirë në çdo fazë të procesit, nga matjet fillestare deri në mbikëqyrjen e punimeve, duke siguruar që rruga të jetë e qëndrueshme, e sigurt dhe të përmbushë kërkesat e projektit.

- Inxhinier gjeolog 1 (një)

Inxhinieri gjeolog është i nevojshem pasi do të hartojë raporte të detajuara për karakteristikat e terrenit dhe ndikimin që mund të kenë ato në projektin e infrastrukturës, duke studiuar dhe analizuar karakteristikat gjeologjike të terrenit ku do të ndërtohet. rikonceptohet rruga dhe bulevardi përpara Bashkisë si dhe për Muzen e qytetit. Kjo përfshin analiza të dheut, shkëmbinjve dhe ujërave në sipërfaqe, për të vlerësuar stabilitetin dhe sigurinë e mundshme gjatë ndërtimit dhe përdorimit të rrugës. Gjithashtu inxhinieri gjeolog identifikon dhe vlerëson mundësinë e fenomeneve natyrore të tilla si rrëshqitjet e dheut, përmytjet, dhe tërmetet, të cilat mund të ndikojnë në sigurinë dhe qëndrueshmërinë e rrugëve dhe ndërtesave.

- Inxhinier Hidroteknik (1 një)

Inxhinieri hidroteknik konsiderohet i nevojshëm për hartimin e projektimit të instalimeve hidro-termosanitare sipas liçensës 4/q. Tek Muzeu i qytetit parashikohen ambiente sanitare të cilat përfshijn vendosjen e lavamanëve, instalimi i bolierve, ventilimi i ktyre hapsirave etj.

- Preventivues (1 një)

Konsiderohet i nevojshëm për preventivimin e investimit për të dy objektet në total, hartimin e preventivave si dhe çmimet për zërat përkatës si dhe të punimeve gjatë realizimit të objektit në përputhje me qëllimin që ka autoriteti kontraktor.

- Specialist Mjedisi (1 një)

Specialist mjedisi konsiderohet i nevojshëm për hartimin e projektimit peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe në përputhje me liçensën 2/d, ku është parashikuar sistemimi i terreneve të jashtme dhe ambienteve të gjelbërta si për muzeun edhe për bulevardin dhe sheshin përpara Bashkisë.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të disponojë certifikatat e mëposhtme:

- Çertifikatë ISO 9001 : 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë)

- Çertifikatë ISO 14001 : 2015 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor)

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatën e mësipërme sipas zërave të punimeve që do të realizojë.

Argumentimi: Kërkesat e mesiperme janë vendosur bazuar në Nenin 79, pika 1 të Ligjit Nr. 162/2020, “Per prokurimin publik”, sipas të cilit: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit” Çertifikatat e cilësisë janë në përputhje me natyrën dhe objektin e kontratës që prokurohet.

a) ISO 9001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë;

Certifikata e Sistemit të Menaxhimit të Cilesise (Quality Management System - QMS): Ky standard ka të bëjë me menaxhimin e cilësisë dhe sigurimin e proceseve të projektit. Certifikimi sipas ISO 9001 konfirmon se studioja ka vendosur standarde të larta për proceset e saj dhe ka një sistem efektiv të menaxhimit të cilësisë.

b) ISO 14001: 2015, Për menaxhimin e cilësisë së mjedisit;

Certifikata e Sistemit të Menaxhimit të Ambientit (Environmental Management System - EMS): Një studio projektuese që merret me dizajnimin e projekteve ndikon në ambientin, kështu që certifikimi sipas ISO 14001 tregon që studioja angazhohet për të pasuruar mjedisin dhe t'i minimizojë ndikimet negative në të.

2.3.6 Operatoret Ekonomik duhet të paraqesin në baze të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, një analize të çmimit të paraqitur në propozimin ekonomik, duke specifikuar sakte të gjithë elementet që kanë marrë parasysh në llogaritjen e çmimit, si dhe duke plotësuar të gjitha kërkesat e V.K.M Nr. 354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe aktet ligjore në fuqi.

2.3.7 Oferta ekonomike duhet të jetë në përputhje me:

Kandidati ofertues në përlllogaritjen e ofertës ekonomike duhet ti referohet në Vendimit te

Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

Tarifa për shërbimet duhet të jetë një vlerë ndërmjet tarifave minimale dhe maksimale, të përcaktuara në këtë manual, në përputhje me ligjin e prokurimit publik, rrjedhimisht ofertuesit nën vlerën minimale do të skualifikohen.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJESIA E PROKURIMIT